

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**, përmes gjyqtarës së vetme gjykuese Snezhana Mihajloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të akuzuarit SH.M. nga ... për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.22302/17 të dt. 26.12.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më dt.17.08.2018, në prezencë të palëve publikisht shpalli

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri **SH.M.** nga babai Z. dhe nëna M., e lindur G., i lindur më dt. ... i martuar, baba i katër fëmijëve, pensionist, i gjendjes së dobët ekonomike, i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

**Ë S H T Ë F A J T O R**

sepse më dt. 02 shtator 2017 rreth orës 13:20 minuta në udhëkryain e rrugës “ ... ” dhe “ ... ” në ..., ka rrezikuar trafikun publik duke e vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre ashtu që duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës “Pasat” me targa të regjistrimit ... nga pakujdesia dhe në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 41 të Ligjit mbi Rregullat e Trafikut Rrugor, në bazë të së cilës shoferi, i cili në rrugë ose në ndonjë hapësirë tjetër të trafikut synon të bëjë ndonjë veprim me mjet, si: hyrjen në trafik, rreshtimin, lëvizjen e mjetit në anën e djathtë ose të majtë, ndërrimin e shiritit të trafikut, tejkalimin, anashkalimin, ndalimin e mjetit, kthimin në anën e djathtë apo në të majtë, kthimin gjysmë rrethor, drejtimin e mjetit mbrapa e të ngjashme, 28 lejohet të fillojë një veprim të tillë vetëm nëse më parë është i bindur se nuk i rrezikon ose nuk i pengon pjesëmarrësit e tjerë në trafik ose nuk e rrezikon pasurinë, kështu që i njëjti duke bërë kthimin në të majtë, pa u bindur se mund ta bëjë një gjë të tillë, me pjesën e përparme të anës së djathtë godet në mesin e anës së majtë veturën e markës “Golf” me targa të regj. ... të cilin e ngiste V.SH., ku si pasojë e këtyre lëshimeve të pandehurit, përveç dëmeve materiale në të dyja automjetet, lëndime të lehta trupore pësojnë të dëmtuarat V.Sh. dhe F.M., të cilat për shkak të natyrës së lëndimeve detyrohen të kërkojnë ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjilan.

- me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1KPRK

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4,41,42,49,50,51,52,73 dhe 74 KPRK si dhe nenit 248 KPPK të pandehurit i shqipton

**DËNIMIN ME KUSHT**

**I.** Të pandehurit i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 3(tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës kohore prej 1(një) viti, nuk kryen tjetër vepër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

**II.** E dëmtuara V.SH. nga ..., kom. ..., për realizimin e kërkesës pronëso- juridike është udhëzuar në kontestin civil.

**III.** Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 20 € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjyimit.

*Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritë aktakuzën penale kundër të akuzuarit Sh.M. nga ..., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1 KPRK.*

*Gjatë seancës fillestare të mbajtur më dt. 17.08.2018 në të cilën është lexuar aktakuza e Prokurorisë së shtetit PP.II.nr.2302/17 e dt.26.12.2017, dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale e cila i vihet në barrë, duke shtuar se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale. Në mbrojtjen e tij i pandehuri Sh.M. deklaroi se pranon se ka kryer veprën penale dhe se pendohet për këtë, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej çfarëdo vepre tjetër penale dhe lutë gjykatën që ta dënoj sa më butë.*

*Në seancën e parë fillestare dhe publike, gjykatësja e vetme gjykuese mori Aktvendim me të cilin aprovoi pranimin e fajësisë, pasi që ka konstatuar se për këtë gjë janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Gjykatësja e vetme ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi është bërë me vullnetin e tij, se pranimi i fajësisë përmban të gjitha faktet të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.*

*Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës kurse me vetë faktin e pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit, ka ardhur në përfundim se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.*

*Bazuar në nenin 73 dhe 74 KPRK me rastin e shqiptimit të dënimit kundër të pandehurit, gjyqtarja e vetme gjykuese mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që nga rrethanat lehtësuese mori parasysh faktin se është baba i katër fëmijëve, se është pensionist, konsideron se ka gabuar, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do kryej vepra penale sepse deri më sot ka jetuar me nder, se është e gjendjes së dobët ekonomike dhe se deri më sot nuk ka qenë i gjykuar. Rrethana rënduese nuk pati.*

*Sipas bindjes së kësaj gjykate shqiptimi i dënimit me kusht ndaj të pandehurit është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit. Gjykata konstatoi se me këtë lloj të dënimit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit nga neni 41 KPRK që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra tjera penale, t'i parandaloj personat tjerë në kryerjen e veprave penale dhe të paraqes gjykimin shoqëror për veprën penale, të rris moralin dhe fuqizoj obligimin për të respektuar ligjin.*

*Nga të cekurat e mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**

*P.nr.31/2018 më dt.17.08.2018*

**Sekretarja juridike,**  
*Suzana Kovaçević*

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**  
*Snezhana Mihajloviq*

**UDHËZIMI JURIDIK:** *Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.*

**Përktheu,**  
*Naile Keçmezi*





